

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 21, datë 19.06.2019

Për përjashtimin nga skema dhe revokimin e certifikatës së sigurimit të depozitave të Bankës së Kreditit të Shqipërisë SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, pika 1, shkronja “a” dhe pikat 2, 3 dhe 4 të tij, të nenit 38, pika 5, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, të nenit 37 të Udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka” të ndryshuar, të nenit 18 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 107, pika 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 202 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 42, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për revokimin e licencës së Bankës së Kreditit të Shqipërisë SH.A.”, të sjellë në Agjenci me shkresë përcjellëse nr.prot 567, datë 17.06.2019, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën e Kreditit të Shqipërisë SH.A., për shkak të fillimit të procesit të likuidimit vullnetar nga ana e vetë bankës.
2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës së Kreditit të Shqipërisë SH.A.
3. Ngarkohet Banka e Kreditit të Shqipërisë SH.A., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave menjëherë pas marrjes së njoftimit të këtij vendimi.
4. Depozitat në Bankën e Kreditit të Shqipërisë SH.A. mbeten të siguruara, deri në përfundimin e procesit të likuidimit vullnetar të saj, që përkon me çregjistrimin e kësaj banke si shoqëri e likuiduar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



KËSHILLI DREJTUES

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.
6. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës dhe Bankën e Kreditit të Shqipërisë lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar